



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE
 Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 864
 Date: 04/06/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	FIM-SER
Titulli i punimit	IDENTIFIKIMI I MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHKOLLËN SH.F.M.U. MAZLLUM KËPUSKA
Kandidatja	BSc. Fitore Saqipi
Mentori	Prof. asoc. Dr. Bedri Dragusha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshilin e Fakultetit	Datë: 23.11.2023 Vendimi Nr.: 2106/2-5

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me numër 2106/2-5 të datës 23.11.2023 është formuar Komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Xhevat Berisha, Kryetar
2. Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha, Mentor
3. Prof. Dr. Rexhep Selimaj, Anëtar

për vlerësimin e punimit të diplomës, të nivelit master, me titullin “**IDENTIFIKIMI I MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHKOLLËN SH.F.M.U. MAZLLUM KËPUSKA**” të kandidatës Bsc. Fitore Saqipi

Komisioni pasi e shqyrtoi materialin e prezantuar-punimin jep këtë:

R A P O R T

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Punimi i masterit me titull “**IDENTIFIKIMI I MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHKOLLËN SH.F.M.U. MAZLLUM KËPUSKA**” të kandidatës Bsc. Fitore Saqipi , është hartuar në 7 kapituj përfshirë kapitujt ndihmës Hyrjen, Përfundimi, Literaturën e shfrytëzuar. Punim ka 63 faqe, 14 figura, 36 tabela.

Punimi i Masterit me titull “**IDENTIFIKIMI I MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SHKOLLËN SH.F.M.U. MAZLLUM KËPUSKA**” të kandidatit Bsc. Fitore Saqipi, është dorëzuar në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë.

Në këtë punim janë analizuar pjesa teknike, ekonomike dhe ndikimi në emetimet e CO₂ për objektin shkollor “Mazllum Kepuska”. Në mënyrë të detajuar, është paraqitur dhe analizuar gjendja ekzistuese e objektit, masat e propozuara për përmirësimin e efiçencës energjetike, si dhe ndikimi ekonomik dhe ambiental i këtyre masave.

Në këtë objekt janë analizuar elementët ndërtimorë (muret, kulmi, dritaret, dyshemeja), sistemet e ngrohjes dhe ndriçimit, si dhe të dhënat e konsumit real dhe të llogaritur të energjisë.

Rezultatet kanë treguar se zbatimi i masave të efijencës mund të sjellë kursime të konsiderueshme në konsum të energjisë, ulje të emetimeve të CO₂ dhe përmirësim të komoditetit të brendshëm të ndërtesës.

Në vazhdim do të jepet përmbledhja për secilin kapitull.

Në kapitullin hyrës, “Hyrje”, është trajtuar rëndësia e efijencës së energjisë në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, me fokus të veçantë në ndërtesat publike në Kosovë. Janë paraqitur qëllimi dhe objektivat e punimit, si dhe metodologjia e ndjekur për realizimin e analizës.

Në kapitullin e dytë, “Performanca energjetike në objekte”, janë paraqitur standardet dhe rregulloret lidhur me performancën energjetike të ndërtesave në Kosovë dhe Bashkimin Evropian. Janë analizuar direktivat evropiane, strategjitë e renovimit dhe kriteret minimale të performancës energjetike.

Në kapitullin e tretë, “Identifikimi i gjendjes ekzistuese”, janë analizuar elementët ndërtimorë të objektit shkollor, përfshirë strukturën e mureve, dritareve, kulmit dhe dyshemesë. Gjithashtu, është përshkruar gjendja e sistemit të ngrohjes dhe ndriçimit.

Në kapitullin e katërt, “Masat për përmirësimin e efijencës së energjisë”, janë propozuar masa të ndryshme për rritjen e efijencës së energjisë të objektit, duke përfshirë izolimin termik të mureve, ndërrimin e dritareve dhe dyerve, dhe instalimin e pajisjeve LED për ndriçim si dhe sistemin e ngrohjes.

Në kapitullin e pestë, “Analiza dhe krahasimi i sistemit të ngrohjes”, janë analizuar sistemet ekzistuese të ngrohjes me kaldajë naftë dhe sistemi i propozuar kallda me pellet me pompë termike. Është bërë krahasimi ndërmjet dy sistemeve, përfshirë kostot, kapacitetin dhe ndikimin në uljen e emetimeve të CO₂.

Në kapitullin e gjashtë, “Kursimet e energjisë dhe financiare”, është realizuar analiza financiare e implementimit të masave të efijencës së energjisë, duke përfshirë periudhën e kthimit të investimit dhe kursimet e pritshme.

Në kapitullin e shtatë, “Përfundime”, janë përmbledhur rezultatet kryesore të analizës dhe janë dhënë rekomandimet për implementimin e masave të efijencës së energjisë, me qëllim përmirësimin e komoditetit termik dhe uljen e kostove të energjisë për objektin shkollor.

Dhe kapitulli i fundit “Referencat”

PËRFUNDIM

Nga analiza e bërë më lartë, konstatohet se kandidatja Bsc. Fitore Saqipi, në punimin e saj të masterit me titull “Identifikimi i masave për përmirësimin e efijencës së energjisë në shkollën SH.F.M.U. Mazllum Kepuska”, ka arritur të zbatojë me sukses njohuritë teorike të fituara gjatë

studimeve, duke i konkretizuar ato në një projekt praktik dhe me ndikim të qartë në kursimin e energjisë dhe përmirësimin e kushteve termike në ambientet shkollore.

Komisioni vlerësues e konsideron këtë punim të përgatitur në mënyrë profesionale, të strukturuar mirë dhe të mbështetur në ilustrime, tabela, figura dhe llogaritje teknike që e bëjnë atë një tërësi të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Vlera e shtuar e këtij punimi qëndron në faktin se ai përqendrohet në analizën e një objekti shkollor publik dhe identifikimin e masave konkrete për përmirësimin e efijencës së energjisë, duke u fokusuar në aspektet teknike dhe financiare të implementimit.

REKOMANDIM

Pas shqyrtimit të detajuar të punimit të paraqitur në këtë raport, Komisioni për vlerësimin e punimit të masterit me titull “Identifikimi i masave për përmirësimin e efijencës së energjisë në shkollën SH.F.M.U. Mazllum Kepuska”, të realizuar nga kandidatja Fitore Saqipi, vlerëson se ky punim përmbush kriteret e kërkuara për një punim masteri. Analizat e kryera në këtë punim vërtetojnë aftësinë dhe suksesin e autores në realizimin e një analize të thelluar dhe të qartë mbi masat e efijencës së energjisë dhe ndikimin e tyre në kursimin e energjisë dhe reduktimin e emetimeve të CO₂.


Duke e vlerësuar këtë punim si të plotë, të mbështetur me rezultate të vlefshme dhe të zbatueshme, komisioni e konsideron të arsyeshme që ky raport të paraqitet për diskutim publik.

Me respekt


Prishtinë: 13/05/2025

Komisioni:

1. Prof. dr. Xhevat Berisha, kryetar/anëtar



2. Prof. asoc. dr. Bedri Dragusha, mentor




2. Prof. dr. Rexhep Selimaj, anëtar



P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI: TERMOENERGJETIKË DHE ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME



PUNIM DIPLOME MASTER
TEMA: IDENTIFIKIMI I MASAVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË
NË SHKOLLËN SH.F.M.U. MAZLLUM KËPUSKA

KANDIDATJA:
BSc. FITORE SAQIPI

MENTORI:
Prof. Asoc. Dr. BEDRI DRAGUSHA

PRISHTINË
2024/2025

Formulari – F3

Hyrje

Energjia ka qenë gjithmonë një faktor thelbësor për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore. Me kalimin e kohës, nevoja për energji është rritur ndjeshëm si pasojë e rritjes së popullsisë, urbanizimit dhe përparimit teknologjik. Aktualisht, kërkesa globale për energji vazhdon të rritet, duke krijuar sfida të mëdha për sigurinë energjetike, qëndrueshmërinë mjedisore dhe zhvillimin ekonomik.

Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (IEA), konsumi global i energjisë është rritur me rreth 1.4% mesatarisht në vit gjatë dekadës së fundit. Në vitin 2023, më shumë se 80% e energjisë primare të konsumuar në botë vinte ende nga burimet fosile: nafta, qymyri dhe gazi natyror. Këto burime, përveçse janë të kufizuara, janë edhe përgjegjëse për rreth 73% të emetimeve globale të gazeve serrë, që janë shkaktari kryesor i ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike.

Në të njëjtën kohë, rritja e vetëdijes për ndikimin mjedisor të modeleve aktuale të konsumit të energjisë ka shtyrë shumë vende të ndërmarrin hapa drejt tranzicionit energjetik dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Një ndër mjetet më efektive në këtë drejtim është përmirësimi i eficiencës të energjisë. Ky koncept nënkupton përdorimin e energjisë në mënyrë më të mençur dhe me humbje sa më të vogla, duke arritur të njëjtin rezultat me më pak konsum energjetik.

Sipas të dhënave të Agjencisë Ndërkombëtare për Eficiencën e Energjisë, përmirësimi i eficiencës në periudhën 2000–2020 ka ndihmuar në shmangien e mbi 12 miliardë tonësh emetime të CO₂. Në vitin 2022, eficienca e energjisë kontribuoi me më shumë se 40% të reduktimeve të emetimeve në vendet anëtare të OECD-së, përmes teknologjive të avancuara në sektorin e ndërtesave, transportit dhe industrisë.

Spektori i ndërtesave, për shembull, është përgjegjës për rreth 30% të konsumit global të energjisë dhe mbi 25% të emetimeve të CO₂. Masat për përmirësimin e izolimit termik, përdorimi i pajisjeve me konsum të ulët të energjisë, dhe implementimi i sistemeve inteligjente për menaxhimin e energjisë mund të çojnë në kursime të konsiderueshme. Po ashtu, sektori i transportit dhe ai industrial përfaqësojnë mundësi të mëdha për optimizim të konsumit përmes elektrifikimit dhe automatizimit.

Në një botë që përballet me sfida të thella klimatike dhe kërkesa gjithnjë në rritje për energji, rritja e eficiencës energjetike nuk është më vetëm një zgjedhje teknike, por një domosdoshmëri strategjike. Përmes politikave të qëndrueshme, investimeve në teknologji moderne dhe ndërgjegjësimin të shoqërisë, eficienca e energjisë mund të luajë një rol kyç në ndërtimin e një të ardhme më të pastër, më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë.

Formulari – F3

Punimi ka këtë përmbajtje:

1. Hyrje;
2. Performanca energjetike në objekte;
3. Identifikimi i gjendjes ekzistuese në SHFMU “Mazllum Këpuska”;
4. Masat për përmirësimin e Efiçencës së energjisë në SHFMU “Mazllum Këpuska”;
5. Analiza dhe krahasimi i sistemit të ngrohjes ekzistues dhe të propozuar;
6. Kursimet e energjisë dhe kursimet financiare
7. Përfundime;
8. Referenca